



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 9, date 30.1.2018

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET E Z.LUIGJ SHPORAJ DHE AGIM CEKAJ, BANESAT E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 30.1.2018, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 54 shkronja “dh”, 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.8756, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, i ndryshuar, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB nr. 85, datë 26.12.2017 “Për buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2018”, Shkresa nr. 3950 prot, datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënie e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Luigj Shporaj** në vlerën prej **80,000 lekë (tetëdhjetë mijë)**, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënie e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së znj. **Agim Cekaj** në vlerën prej **100,000 lekë (njëqind mijë)**, për dëmtimin e banesës nga zjarri.
3. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile në programin 10910 parashikuar në buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2018 të miratuar me VKB nr.85, datë 26.12.2017, në programin P13, F1 O1 A2. (transferime për individë).
4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër.

5. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 266,446 lekë (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 208,900 lekë (dyqind e tetë mijë e nëntëqind) sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z. **Luigj Shporaj**, në total **475,346 lekë (katër qind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzet e gjashtë)**.
6. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 373,473 lekë (treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 264,220 lekë (dyqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e dyqind e njëzet) sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z. **Agim Cekaj**, në total **637,693 lekë (gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre)**.
7. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Punëve të Brendshme për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për familjen e z. Luigj Shporaj dhe familjen e z. Agim Cekaj, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012, për shkak të pamundësisë së bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
8. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës prej 180,000 lekë.
9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.1.2018

Shpallur në datën 31.1.2018

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI